



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE TË ZHVILLIMIT
TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN E MINIERAVE DHE
INDUSTRIËS**

Nr. 5521/Prot.

Tiranë, më 13.07.2026

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1616, datë 06.03.2013.

SHOQËRISË “MINERALUNIT” SH.P.K

Rrajcë, Librazhd, Elbasan

**Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË
MINIERA**

Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë

Shoqëria “MINERALUNIT” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1616, datë 06.03.2013, për mineralin Hekur-Nikel, në Objektin “Përroi i Shpellës”, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr. 3601 Prot., datë 29.06.2026, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr. 5521, datë 01.07.2026, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1616, datë 06.03.2013, për mineralin Hekur-Nikel, në objektin “Përroi i Shpellës”, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan, pasi nuk ka respektuar kërkesat e legjislacionit minerar, lidhur me pagesën e garancisë financiare të rehabilitimit të mjedisit për vitin 2026.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma “ç”, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1616, datë 06.03.2013**, për mineralin Hekur-Nikel, në Objektin “Përroi i Shpellës”, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan., që shoqëria Juaj zotëron.

Referuar pikës 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", subjekti ka të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesë sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1616, datë 06.03.2013, për mineralin Hekur-Nikel, në Objektin “Përroi i Shpellës”, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni 48 “Procedura e revokimit të lejes”, të ligjit Nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

MINISTRI
ENEA KARAKAÇI

ME URDHËR PËR DELEGIM
ZËVENDËSMINISTRI
ERLIND SULO



The image shows a handwritten signature in blue ink, which appears to be 'ERLIND SULO', written over a circular official stamp. The stamp contains the text 'REPUBLIKA E SHQIPËRISE' at the top, 'MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË' around the perimeter, and 'TIRANË' at the bottom. In the center of the stamp is the coat of arms of Albania.